

16 Qershor, 2022

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Sot mirëpresim superintendent tonë të ri, Dr. Tony Watlington. Ju ftojmë të kaloni një moment për të parë një video-mesazh të veçantë nga superintendenti ynë i ri. Shikoni videon [këtu](#) dhe gjeni skenarin për videon në shumë gjuhë në www.philasd.org/100days.

Siç u përmend në video, përparësia e parë e superintendentit tonë të ri gjatë 100 ditëve të ardhshme është të dëgjohet dhe të mësojë. Ai dëshiron të njohë qytetin tonë të madh, të mësojë se çfarë bën mirë Drejtoria dhe ku nevojitet përmirësim për të arritur Qëllimet dhe Objektivat e Bordit. Në këtë frymë, ju jeni të ftuar personalisht të bashkoheni me Superintendent Watlington në një nga seancat e Dëgjimit dhe të Mësimit që janë të destinuara posaçërisht për të dëgjuar dhe mësuar drejtpërdrejt nga studentët dhe familjet tona.

Mund të gjeni një listë të këtyre mundësive të angazhimit, të lexoni më shumë rreth qëllimeve dhe veprimeve të superintendent për 100 ditët e para, të monitoroni përparimin e tij në arritjen e tyre dhe më shumë duke vizituar www.philasd.org/100days.

Mezi presim të angazhohemi me ju këtë verë dhe të mirëpresim të gjithë nxënësit tanë në shkollë të Hënën, më datën 29 Gusht.

Sinqerisht,

Drejtorja Arsimore e Filadelfias
Zyra e Komunikimit